



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:200582

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06598769

C.nr. 583/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses S, me seli në Prishtinë, rruga “....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, përfaqësuesi i autorizuar A.A, jurist i diplomuar, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurit V.S.Th nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, me bazë juridike rimbursim i dëmit, vlera objektit të kontestit 6,602.32 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, më datën 02.12.2024 mori, ndërsa me datë 13.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses S, me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri V.S.Th nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 28.04.2022, në fshatin Landovicë, Komuna e Prizrenit, paditëses të i'a kompensojë shumën prej 6,602.32 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 29.09.2022 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri V.S.Th, në emër të shpenzimeve procedurale paditëses S, të i'a paguajë shumën prej 40,00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesve të saj të autorizuar më datën 29.09.2022, në këtë gjykatë ndaj të paditurit V.S.Th nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar padinë për rimbursim të dëmit, në shumën prej 6,602.32 euro, të precizuar në seancën e shqyrtimit përgatitor.

Gjykata, lidhur me këtë çështje kontestimore ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 02.12.2024, dhe ka tentuar që të paditurit të ia dorëzojë ftesën për seancë sipas adresës në padi, mirëpo tentimi dorëzimi ka rezultuar i pasuksesshëm sepse i padituri ka ndërruar adresën e vendbanimit – vendqëndrimin, ndërsa lidhur me ndryshimin e adresës nuk e ka njoftuar gjykatën,

ndërsa nga dorëzuesi i shërbimit postar është konstatuar se pala është shpërngulur në Gjermani, sipas deklaramit të prindërit. Në nenin 116 par. 5 të LPK-së përcaktohet: “Në çoftë se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë menjëherë gjykatën për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e mëtutjeshme të shkresave të bëhen me anë të afishim të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e re të saj”, ndërsa sipas nenit 116 par. 6 është përcaktuar: “Komunikimi nga paragrafi 5 i këtij nenin konsiderohet i kryer pas kalimit të shtatë ditëve nga dita e afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve të gjykatës.” Andaj, gjykata duke pasur parasysh faktin se i padituri nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës, edhe pse ka qenë obligimi i tij ligjor, gjykata komunikimin me të njëjtin e ka bërë përmes afishimit në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 116 par. 5 dhe 6 të LPK-së.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.1 të LPK-së.

I autorizuari i paditëses A.A, në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare kanë deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj. I njëjti ka theksuar se konform nenit 257 të LPK-së, i propozon gjykatës që ti lejojë zgjerimin e padisë në aspektin objektiv të saj, lidhur me dy kërkesa për dëme materiale, me nr.ref. 00713/TPL22/JM08 dhe JM09, ku janë të lënduar: A.B dhe B.A, në aksidentin e datës 28.04.2022, në të cilin ka qenë shkaktar i padituri V.S.Th, i cili në momentin e aksidentit ka qenë nën ndikim të alkoolit, me çka edhe ka humbur mbulesën siguruese. Më tej ka shtuar se vlera fillestare e padisë ka qenë 4,944.32 Euro, ndërsa vlera pas zgjerimit 6,602.32 Euro. Gjykatës i ka dorëzuar dhe këto prova: Vlerësimin e dëmit për rastin 00713/TPL22/JM08, marrëveshjen jashtëgjyqësore të datës 01.07.2022, me të dëmtuarën B.A, me nr.ref. 00713/TPL22/JM08, urdhërpagesën e dëmit dhe transferin bankar, me nr.ref. 00713/TPL22/JM08, vlerësimin e dëmit, me nr.ref. 00713/TPL22/JM09, marrëveshjen jashtëgjyqësore, me të dëmtuarin A.B, me nr.ref. 00713/TPL22/JM09, urdhërpagesën dhe transferin, me nr.ref. 00713/TPL22/JM09. Po ashtu ka theksuar se e kanë pranuar përgjigjen në padi të të paditurit, ndërsa i njëjti nuk e konteston as bazën dhe as lartësinë. Nga provat e administruara u vërtetua në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj kërkojnë që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe të detyrohet i padituri V.Th që paditëses të ia rimbursojë mjetet në emër të rimbursimit të dëmit, shumë e përgjithshme prej 6,602.32 Euro, me kamatë ligjore siç është paraparë në petitumin e padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I paditur V.Th, përmes përgjigjes në padi të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 12.04.2023, ka deklaruar se nga përmbajta e padisë rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për arsye se pretendimet e paditësit qëndrojnë në tërësi siç pretendon në padi. I njëjti ka theksuar se e lut gjykatën që të paditurit t’ia mundësojë pagesën e të hollave me këste, pasi që nuk është në marrëdhënie pune dhe nuk ka mundësi që ta kryej pagesën menjëherë. Gjithashtu ka kërkuar nga gjykata ta lirojë prej shpenzimeve procedurale dhe kamata.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 02.12.2024,

sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: Kërkesën për rimbursimin e borxhit, të S, me nr. 607, të datës 01.09.2022; pasqyrën e transaksionit bankar, të P, e nënvizuar në shumë prej 1,444.32 Euro, e datës 22.07.2022; urdhërpagesën dëmi, të S, me nr. 00713/TPL/22/V01, të datës 19.07.2022; faturën, me nr. 399, të datës 13.07.2022, e lëshuar nga B, në fshatin Sopijë, Komuna e Suharekës, me NUI 810632332; certifikatën e regjistrimit të automjetit, me nr. CRA1725549, për automjetin A1, me nr. të targave ...; njoftimin për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/V01, për D.B, drejtuar V.Th t; akt-ekspertimin e dëmit, i paditëses, i datës së ekspertimit 13.05.2022, në Prizren; policën e sigurimit, me nr. të policës 0008008971, S1; konfirmimin e sigurimit-MTPL, për automjetin me targa ...; deklaratën e D.B, për S; 9 foto bardhë e zi, të paraqitura në një faqe A4; njoftimin e rastit të siguruar, të S, me referencë të dëmit 0713/TPL/22/V01; raportin e aksidentit, të Policisë së Kosovës, 2022-GR-257, me datë të aksidentit 20.04.2022 dhe datë të raportit 28.04.2022, së bashku me skicën e vendit të ngjarjes; TPL (e përgjithshme), me nr. të serisë 9264990, të S; kërkesën për rimbursimin e borxhit, të S, me nr. 536, të datës 27.07.2022; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM02; njoftimin për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/JM02, për P.B, drejtuar V.Th; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM06; njoftimin për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/JM06, për O.H, drejtuar V.Th; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM04; njoftim për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/JM04, për S.B, drejtuar V.Th t; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM05; njoftimin për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/JM05, për N.B, drejtuar V.Th t; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM07; njoftimin për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/JM07, për A1.B, drejtuar V.Th t; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM03; njoftimin për regresim të vlerës së dëmit, me nr. 00713/TPL/22/JM03, për L.B, drejtuar V.Th t; transaksionet bankare, prej nr. 00713/TPL/22/JM02 deri 00713/TPL/22/JM07, përmes P, për avokatin B.J, datë 27.06.2022; urdhërpagesat e dëmit, prej nr. 00713/TPL/22/JM02 deri 00713/TPL/22/JM07, përmes P, për avokatin B.J, datë 24.06.2022; vlerësim i dëmit, për rastin 00713/TPL/22/JM08; marrëveshje jashtëgjyqësore, e datës 01.07.2022, me të dëmtuarën B.A, me nr.ref. 00713/TPL/22/JM08; urdhërpagesën e dëmit dhe transfer bankar, me nr.ref. 00713/TPL/22/JM08; vlerësimin dëmi, me nr.ref. 00713/TPL/22/JM09; marrëveshjen jashtëgjyqësore, me të dëmtuarin A.B, me nr.ref. 00713/TPL/22/JM09, dhe urdhërpagesë dhe transfer, me nr.ref. 00713/TPL/22/JM09.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në këtë çështje kontestimore ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike dhe as lartësia e kërkesës.

Me administrimin e raportit të aksidentit, të Policisë së Kosovës, me nr. 2022-GR-257, me datë të aksidentit 28.04.2022, gjykata vërtetoi faktin se aksidenti i trafikut i datës 28.04.2022 është shkaktuar për shkak se vozitësi i automjetit të tipit M e targa ..., të cilin ka qenë duke e drejtuar i padituri V.Th, lëvizte prej rrugës magjistrale tranist, dhe me të arritur pranë qendrës për

grumbullimin e mbeturinave në Landovicë, në drejtim të qendrës me të arritur tek kthesa e parë, i njëjti duke mos iu përshtat kushteve dhe rrethanave të rrugës fillon tejkalimin e një kamioni transportues me dy rimorkio, ku në pamundësi që të kthehet në shiritin qarkullues, del komplet në krahun tjetër të lëvizjes, ku edhe e godet ballë për ballë automjetin e tipit A2, me targa ..., i cili ka qenë duke lëvizur nga drejtimi i kundërt, ku si pasojë e goditjes ballore, përveç dëmeve të shkaktuara në automjete, lëndime trupore kanë pësuar vozitësja e automjetit të tipit A2, dhe gjashtë pasagjerët që ishin në automjet, si dhe tre pasagjerët e automjetit "M. Po ashtu është vërtetuar fakti se vozitësi i automjetit M në rastin konkret i padituri V.Th në kohën e shkakimit të aksidentit ka qenë nën ndikim të alkoolit, ku pas matjes me alkool test ka rezultuar në 1.67 promil alkool.

Me administrimin e kërkesës për rimbursimin e borxhit, të S, me nr. 607, të datës 01.09.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka parashtruar kërkesë ndaj të paditurit për rimbursim të dëmit në shumë prej 1,444.32 euro, lidhur me pagesën të cilën e ka realizuar ndaj të dëmtuarit D.B.

Me administrimin e urdhërpagesën dëmi, të S, me nr. 00713/TPL/22/V01, të datës 19.07.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka urdhëruar pagesën e shumës prej 1,444,32 euro në llogari të "B1, lidhur me kompensimit e dëmit të shkaktuar në automjetin e të dëmtuarit D.B, dëmi i cili është shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e pasqyrës të transaksionit bankar, të P, e nënvizuar në shumë prej 1,444.32 Euro, e datës 22.07.2022, gjykata vërtetoi faktin nga paditësja së në llogari të "B1, ka transferuar shuma prej 1,444,32 euro, në emër të riparimit të dëmit në automjetin e tipit A2, me targa

Me administrimin e faturës, me nr. 399, e datës 13.07.2022, e lëshuar nga B, në fshatin Sopijë, Komuna e Suharekës, me NUI 810632332, gjykata vërtetoi faktin dëmi i cili është shkaktuar në automjetin e tipit A2, me targa ..., në aksidentin e datës 28.04.2022, është në shumën prej 1,444,32 euro.

Me administrimin të policës të sigurimit, me nr. të policës 0008008971, S1, gjykata vërtetoi faktin se automjeti A1, me nr. të targave ..., pronë e D.B ka pasur mbulueshmëri të sigurimit nga data 03.09.2021 deri me datën 03.09.2022.

Me administrimin e konfirmimin e sigurimit-MTPL, për automjetin me targa ..., gjykata vërtetoi faktin se automjeti i tipit M me targa ..., të cilin ka qenë duke i drejtuar i padituri V.Th, i cili edhe e ka shkaktuar aksidentin e trafikut të datës 28.04.2022, ka qenë i siguruar tek paditësja me mbulueshmëri të sigurimit nga data 01.02.2022 deri më datën 01.02.2023.

Me administrimin e kërkesës për rimbursimin e borxhit, të S, me nr. 536, të datës 27.07.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka parashtruar kërkesë ndaj të paditurit për rimbursim të dëmit në shumë prej 3,500.00 euro, lidhur me pagesën të cilën e ka realizuar ndaj të dëmtuare P.B, L.B, S.B, N.B, P.H, dhe A1.B.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM02, gjykata vërtetoi faktin se me datë 26.05.2022, paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës P.B, Av. B.J

kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 600.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM06, gjykata vërtetoi faktin se me datë 26.05.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës O.H, Av. B.J kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 600.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM04, gjykata vërtetoi faktin se me datë 26.05.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarit S.B, Av. B.J kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 600.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM05, gjykata vërtetoi faktin se me datë 26.05.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës N.B, Av. B.J kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 950.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM07, gjykata vërtetoi faktin se me datë 26.05.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarit A1.B, Av. B.J kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 150.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM03, gjykata vërtetoi faktin se me datë 26.05.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarit L.B, Av. B.J kanë arritur marrëveshje për kompensim të dëmit, në shumë prej 600.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e transaksionit bankare, të realizuar përmes P, me datë 27.06.2022, prej nr. 00713/TPL/22/JM02 deri 00713/TPL/22/JM07, për avokatin B.J, gjykata vërtetoi faktin nga paditësja së në llogari të Av. B.J ka transferuar shuma e përgjithshme prej 3,500.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022 dhe atë për të dëmtuarit P.B, L.B, S.B, N.B, P.H, dhe A1.B.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM09, gjykata vërtetoi faktin se me datë 08.06.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarit A.B, Av. A.M kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 829.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e transaksionit bankare, të realizuar përmes P, me datë 08.08.2022, për avokatin A.M, gjykata vërtetoi faktin nga paditësja së në llogari të Av. A.M ka transferuar shuma e përgjithshme prej 829.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022 dhe atë për të dëmtuarin A.B.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore, me referencë 00713/TPL/22/JM08, gjykata vërtetoi faktin se me datë 08.06.2022 paditësja dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës B.A, Av. H.B1

kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensim të dëmit, në shumë prej 829.00. euro, të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022.

Me administrimin e transaksionit bankare, të realizuar përmes P, me datë 08.08.2022, për avokatin H.B1, gjykata vërtetoi faktin nga paditësja së në llogari të Av. H.B1 ka transferuar shuma e përgjithshme prej 829.00 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 28.04.2022 dhe atë për të dëmtuarën B.A.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas nenit 136 par.1 të LMD-së parashihet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018 në nenin 14 par.1 përcaktohet se *“I siguruari e humbë mbulesën siguroese, kur: 1.3 mjeti motorik drejtohet nën ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psiko-aktive”*, si në dhe par.3 përcaktohet se *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese”*, ndërsa neni 12 par.1 e përcakton se *“Fondet e sigurimeve shëndetësore, personale dhe invalidore kanë të drejtë, lidhur me detyrimet e përmbushura ndaj siguruesve të tyre, të parashatrojnë kërkesa regresi nga baza e sigurimit të auto përgjegjësive për rimbursimin e dëmit real, brenda kufijve të përgjegjësive të siguruarit me kontratë, pasi që ato janë paguar”*.

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të lartpërmendura, të cilave ua fali besimin e plotë, e duke analizuar edhe thëniet e palës paditëse në procedurë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Krejt kjo bazuar në faktin se gjykata e ka vërtetuar faktin se me datë të aksidentit 28.04.2022, është shkaktuar aksident për shkak se vozitësi i automjetit të tipit M me targa ..., të cilin ka qenë duke e drejtuar i padituri V.Th, i cili ka qenë duke lëvizur prej rrugës magjistrale tranist, dhe me të arritur pranë qendrës për grumbullimin e mbeturinave në Landovicë, në drejtim të qendrës me të arritur tek kthesa e parë, duke mos iu përshtatur kushteve dhe rrethanave të rrugës fillon tejkalimin e një kamioni transportues me dy rimorkio, ku i njëjti në pamundësi të kthehet në shiritin qarkullues, del komplet në krahun tjetër të lëvizjes, ku edhe e godet ballë për ballë automjetin e tipit A2, me targa ..., i cili ka qenë duke lëvizur nga drejtimi i kundërt. Po ashtu është vërtetuar fakti se si pasojë e goditjes ballore, përveç dëmeve të shkaktuara në automjete, lëndime trupore kanë pësuar vozitësja e automjetit të tipit A2, gjashtë pasagjerët që ishin në automjet, si dhe tre pasagjerët e automjetit “M. Po ashtu është vërtetuar fakti se vozitësi i automjetit M në rastin konkret i padituri V.Th në kohën e shkaktimit të aksidentit ka qenë nën ndikim të alkoolit, ku pas matjes me alkool test ka rezultuar në 1.67 promil alkool. Vetë pala e paditur në përgjigjen në padi i ka pohuar këto fakte dhe ka kërkuar nga gjykata që pagesën ta bëjë me këste, por që nuk ka prezantuar në seancat gjyqësore.

Sa i përket lartësisë së dëmit të shkaktuar, gjykata vendosi për kompensimin e paditëses si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate dhe atë sipas marrëveshjeve jashtëgjyqësore të arritura ndërmjet paditëses me të dëmtuarit dhe raporteve të transaksionit bankar, të datës 27.06.2022, si dhe transaksionit bankar të datës 08.08.2022, gjykata

ka vërtetuar faktin se paditësja S, të dëmtuarën P.B e ka kompensuar në shumën prej 600.00 euro, të dëmtuarën O.H në shumën prej 600.00 euro, të dëmtuarin S.B në shumën prej 600.00 euro, të dëmtuarën N.B në shumën prej 600.00 euro, të dëmtuarin A1.B në shumën prej 150.00 euro, të dëmtuarin L.B në shumën prej 600.00 euro, të dëmtuarin A.B në shumë prej 829.00 euro, dhe të dëmtuarës B.A në shumën prej 829.00 euro, apo gjithsej shuma e përgjithshme e kompensuar nga paditësja në vlerë prej 6,602.32 euro.

Lidhur me pretendimet e të paditurit me të cilat ka kërkuar që i njëjti të lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore, gjykata i vlerëson si pretendime të pabazuara. Në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, në nenin 8 Lirimi nga pagesa e taksave, përcaktohet: *“8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si në vijim: 8.1.1 personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla 8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai 8.1.3 Familjet e dëshmorëve të UÇK dhe të zhdukurve në luftime 8.1.4 Invalidët e UÇK -së dhe 8.1.5 Familjet e viktimave civile të luftës.* Andaj, gjykata duke marr parasysh se paditësi gjykatës nuk ia ka prezantuar asnjë provë, për ta vërtetuar faktin se i njëjti përfshihet në ndonjë nga kategoritë e lartcekura të parapara për lirim nga taksa gjyqësore, andaj propozimin e të njëjti e ka refuzuar si të pa bazuar.

Prandaj, gjykata gjatë procedurës bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse në arsyetimin e aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar në marrjen e vendimit si më lartë, duke u bazuar në nenin 143 par. 1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore”*, për çka ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë. Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par. 1, nenit 174 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që i padituri t’ia kompensojë paditëses shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen, taksës gjyqësore në shumë prej 40.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.583/2022, më datë 13.12.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.